



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 01 tetor 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Adem Mikullovi, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje mungoi: Milaim Zeka.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, OSBE-së, KDI-së, INPO, RTK2, Kallxo.com, Ekonomia online, Kosovapress dhe Radio- Kosova.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-097, për Transmetuesin Publik të Kosovës;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-092, për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit

Procesverbalet u miratuan me vërejtjen e kryetarit të komisionit, Nait Hasani, i cili kërkoi që në procesverbalin e dt. 24 shtator 2018, të inkorporohet diskutimi i deputetit Milaim Zeka, i cili kishte komentuar diskutimin e z. Nait Hasani që gjoja kishte thënë se e urren gjuhën serbe, e që sipas tij kjo nuk qëndron dhe çështja në fjalë do të shqyrtohet po sa të kthehet në komisionin e deputetit, Milaim Zeka.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-097, për Transmetuesin Publik të Kosovës

Nait Hasani njoftoi komisionin se P/ligji për Transmetuesin Publik, hartues i së cilit është Komisioni Funkcional, ka arritur në Kuvend nga Qeveria pas procedurave për mendim, brenda procedurave të parapara me rregulloren e Kuvendit dhe i propozoi anëtarëve të komisionit që me të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e propozuara nga Qeveria, të procedohet për miratim në parim në Kuvend, në mënyrë që në fazën e amendamentimit të shqyrtohen të gjitha propozimet.

Xhevahire Izmaku tha se komisioni ka bërë një punë të mirë, P/ligji i plotëson kriteret për miratim në parim, ndërsa që me plotësimin e P/ligjit me vërejtjet dhe rekomandimet e propozuara ligji do të jetë më kualitativ për implementim.

Shqipe Pantina u deklarua se e përkrah miratimin në parim të P/ligjit me qëllim të shmangies së ndërhyrjeve politike dhe funksionimit me të mirë të RTK-së. Ajo propozoi që të plotësohen nenet e draftit që kanë të bëjnë me menaxhimin e bordit, ndryshe vota e saj, pas leximit të dytë, do të jetë e kushtëzuar.

Albert Kinolli u deklarua se e përkrah miratimin në parim të P/ligjit pasi që komisioni ka bërë një punë të mirë gjatë hartimit të draftligjit.

Jasmina Zhivković, tha se, si anëtare e komisionit, e barabartë me anëtarët e tjerë, nuk e ka pasur tekstin e draftit në gjuhën e vet amtare dhe se për herë të parë e ka tekstin në gjuhën serbe dhe për këtë arsye nuk ka kontribuar në hartimin e draftligjit, mbi këtë bazë nuk mund të vlerësojë se çfarë është P/ligji, por që propozimet e veta do t'i jap në fazën e amendamentimit.

Adem Mikullovi tha se P/ligji ka mangësi, për çështjen e numrit të mbledhjeve dhe zgjedhjen e drejtorëve të RTK, nuk është precizuar se a rregullohen me ligj apo statut të RTK-së. Pagesa e parapagimit nëpërmjet faturës së rrymës është zgjidhje e gabuar.

Rasim Selmanaj, edhe pse gjatë hartimit të draftligjit ka pasur mendime të ndryshme lidhur me mënyrën e financimit, u deklarua se e përkrah miratimin në parim të P/ligjit.

Imet Rrahmani tha se të gjitha vërejtjet, propozimet e adresuara në komision, duhet të shqyrtohen pavarësisht a miratohen apo refuzohen dhe çdo procedim i P/ligjit pa shqyrtimin e vërejtjeve është hap i ngutshëm. Ai propozoi, që vërejtjet dhe propozimet e të gjitha institucioneve, grupeve të interesit të shqyrtohen një nga një dhe t'ju përgjigjemi .

Valon Ramadani tha se qëndron fakti se është bërë punë kohë të gjatë, por për shumë çështje ka pasur mospajtime, veçanërisht për çështjen e financimit të RTK-së, pastaj hartimi i draftit pa

ekspert të fushës. Komisioni duhet t'i shqyrtojë çështjet diskutabile para se të procedojë P/ligjin për miratim në parim.

Nait Hasani u pajtua me vërejtjet e sipërsënuara dhe u deklarua se ekspertët do t'i angazhojë komisioni në fazën e amendamentimit.

Imet Rrahmani, pyeti:

- Cila është logjika e procedimit të P/ligjit pa diskutim lidhur me hapjen e kanalit për diasporën që është edhe rekomandim i Qeverisë?
- Sa do të kushtojë hapja e një kanali të ri për diasporën, sa do të kushton digjitalizimi i arkivës, a kërkohet buxhet shtesë nga themeluesi për këto çështje?

Shqipe Pantina, pyeti rreth procedurës, nëse komisioni nuk e voton P/ligjin për miratim në parim, kujt i kthehet.

Konstatim:

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve të diskutuesëve, anëtarët e komisionit nga radhët e opozitës e lëshuan mbledhjen dhe në mungesë të kuorumit mbledhja u shty për ditën e mërkurë, dt. 03 tetor 2018, në orën: 10:00, për të vazhduar me të njëjtin rend dite dhe me pikat e rendit të ditës, sipas ftesës për mbledhje të përcaktuar më parë.

Mbledhja përfundoi në orën:11:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani